

NOTE INFORMUESE

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore “Shkarkimin nga detyra” ndaj magjistratëve P.Dh., P.Ç.

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka vendosur më 24.02.2021 vazhdimin e hetimit disiplinor të pezulluar më datë 20.03.2018, ndaj magjistratëve K.S., P.Ç. dhe P. Dh. të Gjykatës së Apelit Durrës, për shkelje të rënda të etikës gjyqësore, si dhe ndryshimin e objektit të hetimit disiplinor të filluar më 17.01.2018 ndaj magjistratëve K.S., P.Ç. dhe P. Dh. për shkelje të rënda të etikës gjyqësore, në shkeljen disiplinore për shkak të kryerjes së një krimi për të cilin secili magjistrat është dënuar me vendim të formës së prerë.

P.Ç. dhe P. Dh, njëloj si kolegu i tyre K.S. janë deklaruar fajtorë për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, sipas nenit 319/ç të Kodit Penal, me vendimin nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit me vendimin nr. 19, datë 21.09.2020.

Kur shkelja disiplinore identifikohet me kryerjen e një krimi, për të cilin magjistrati është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, passjell shkarkimin nga detyra të magjistratit, si një masë me natyrë përjashtuese nga sistemi gjyqësor, me karakter të përhershëm, e cila nuk shuhet.

Raporti hetimor i ILD vëren se nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore, ajo e kryerjes së një krimi për të cilin janë dënuar me vendim të formës së prerë, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”; provohet se magjistratët P.Ç. dhe P. Dh kanë diskretituar pozitën dhe figurën e magjistratit, kanë cënuar rëndë imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

Për pasojë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- Caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga nenet 104, pika 3 dhe 111 të ligjit nr. 96/ 2016, për magjistratin P. Ç.;
- Caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga nenet 104, pika 3 dhe 111 të ligjit nr. 96/ 2016, për magjistratin P. Dh.